



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:005125

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730618

K.DH.SH.II.nr.1667/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, me numër të regjistrimit të biznesit 70280741, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R.Xh., kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.325/22 i datës 27.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektoratit të Punës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.325/22 i datës 27.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë me aktgjykimin e atakuar KA.nr.325/22 i datës 27.10.2023, në pikën I. të dispozitivit, Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh.A. Në pikën II të dispozitivit, Ndryshohet vendimi nr.660/19 i datës 04.11.2019 i nxjerrë nga i padituri

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës si organ i shkallës së dytë, ashtu që aprovohet ankesa e paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, dhe anulohet vendimi nr.209/2019 i datës 05.09.2019 i Inspektoratit të Punës si i kundërligjshëm. Nën pikën III. Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të Avokaturës Shtetërore për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe çështja ti kthehet të njëjtës në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se dhe:

Ankesa e të paditurës është e pa-bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati i Punës me vendimin nr.660/2019 i datës 04.11.2019, ka vendosur: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë Telekomi i Kosovës Sh.A në Prishtinë, e përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv B.I.. Dhe vërtetohet vendimi i Organit të Shkallës së Parë Inspektoratit të Punës nr.209/2019 i datës 05.09.2019.

Dhoma e Shkallës së Parë duke vepruar sipas padisë me aktgjykimin KA.nr.325/22 i datës 27.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka ndryshuar vendimin nr.660/2019 të datës 04.11.2019, ashtu që ka aprovuar ankesën e paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh.A dhe ka anuluar vendimin nr. 209/2019 të datës 05.09.2019 të Inspektoratit të Punës si të

kundërligjshëm. Në arsyetim të aktgjykimit Dhoma e Shkallës së Parë ka konstatuar se gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 6 par.3 të Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë. Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit sepse vlerëson se vendimi i të paditurës është nxjerrë nën tejkallim të kompetencave ligjore të cilat Inspektorati i Punës sipas ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjin nr.03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, këtu ndërlidhur edhe me Ligjin e Punës i cili përcakton kompetencën për rastet kur i punësuar nuk është i kënaqur me vendimin e punëdhënësit. Lidhur me kompetencën e të paditurit gjykata iu referua nenit 2 të Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë. Gjykata iu referua nenit 79 të ligjit të punës i cili përcakton se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (300 ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”. Po ashtu gjykata iu referua edhe Ligjit nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminim, i cili garanton mbrojtje nga diskriminimi në kontestin e marrëdhënies së punës. Neni 13 i këtij ligji përcakton se “Çdo person ose grup i personave që ankohen se kanë qenë të diskriminuar mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji mund të paraqesin padi në gjykatën kompetente”. Gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurit Inspektorati i Punës, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast të gjykatës. Gjykata vlerëson se i padituri ka tejkalluar kompetencat e tij kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin me të cilin ishte konstatuar ekzistimi i diskriminimit lidhur me përcaktimin e gradave. Prandaj gjykata duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në kuptim të nenit 43 par.3 dhe nenit 46 par.4 të Ligjit për konfliktet Administrative e vërtetoi vetë gjendjen faktike si më lartë si dhe me aktgjykim vendosi për çështjen administrative në mënyrë meritore pasi që të dhënat dhe provat e administruara gjatë procedurës kanë dhënë bazë të sigurt për të vendosur në mënyrë meritore. Gjykata shqyrtimin e nulitetit të vendimit kontestues e bëri sipas pretendimeve të paditësit dhe detyrës zyrtare në kuptim të par. 2 të nenit 44 të LKA-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: “*në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të*

cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbali për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit” e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në rastin konkret Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon përfundimin e Dhomës së Shkallës së Parë, për shkak se gjykata e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për aprovimin e padisë dhe ndryshimin e aktit administrativ – vendimin e të paditurës, andaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kolegji vlerësoi se dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, është i qartë dhe nuk është kontradiktor me vetveten ose arsyet e tij, Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar se i padituri ka tejkaluar kompetencat e tij kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin me të cilin ishte konstatuar ekzistimi i diskriminimit lidhur me përcaktimin e gardave, për shkak se kompetencat e Inspektoratit të Punës duhet të kenë nën mbikëqyrje zbatimin e Ligjit të Punës, Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës dhe në rast të konstatimit të shkeljeve eventuale, në kuptim të nenit 5 par 5.5 pika b) dhe c) Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë dhe Ligjit nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr.2002/9, Inspektorati i Punës mund të jap vërejtje me shkrim për parregullsitë e konstatuara apo të shqiptoj gjobë, por assesi të konstatoj ekzistimin apo jo të diskriminimit në kontest të marrëdhënies së punës si në rastin konkret, pasi që përcaktimi i gradave është bërë përmes kontratës së punës, për çka palët janë dakorduar vullnetshëm. Për më tepër, është kompetencë e gjykatës që të vlerësoj ekzistimin apo jo të diskriminimit. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë iu referua nenit 52 par.1 të LPPA-së i cili përcakton se 1. “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1 është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji, 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë...” Po ashtu nenit 43 par.2 të LKA-së i cili përcakton se: “2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga

faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe ndryshimit të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Kolegji vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1667/23, me datë 24.05.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**